



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

OPINION MBI KANDIDATIN ARENS ÇELA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53, 54, 56 dhe 58 të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 19.12.2019 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar si ndihmësmagjistrat me pëlqimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme, në pozicionet:

- 1. Pozicionin e “Drejtorit të Kabinetit” të Prokurorit të Përgjithshëm;*
- 2. Pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Dekriminalizimit”, si dhe;*
- 3. Pozicionin e specialistit/ ndihmësmagjistratit në Drejtorinë e Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore.*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kanë paraqitur kërkesë 4 (katër) prokurorë dhe Znj.Etmonda Hoxha (së cilës i është kthyer përgjigja me shkresën datë 14.01.2020, pasi nuk plotëson kushtet e kandidimit).

Në datë 27.12.2019, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit Arens Çela, i cili ushtron funksionin e prokurorit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin specialistit/ndihmësmagjistratit në Drejtorinë e Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në nenin 54/4, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor, pasi ka verifikuar ekzistencën ose jo, të ndonjë prej kriterëve ndaluese, si dhe duke vlerësuar cenimin apo dëmtimin

e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokurori Arens Çela ushtron funksionin e magjistratit që prej datës 04.10.2006, pasi me dekretin nr. 5053, datë 04.10.2006, të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në stazh, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lushnjë. Nga dosja personale rezulton se ka patur disa transferime si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, Lushnjë dhe në Prokurorinë për Krimet e Rënda, si dhe ka patur pozicion Drejtuesi nga data 03.04.2013 deri më 18.02.2016. Ai ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 10 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë i komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte, për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë, ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë rezulton se:

Nga kthim-përgjigja nr. 208/1 Prot., datë 08.01.2020, e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, rezulton se nisur nga ngarkesa në punë e prokurorëve Pranvera Pustina, Ols Dado dhe Arens Çela, komandimi i tyre pranë Prokurorisë së Përgjithshme nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se, komandimi i Z. Arens Çela në Prokurorinë e Përgjithshme, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo prokurori, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj prokurorie, për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

- Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Arens Çela.

Në mbledhjen plenare të datës 15.01.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi opinionin pozitiv mbi kandidatin Arens Çela.

Ky opinion publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Data: 15.01.2020